



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 28. 10. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi anëtar
19. Lulzim Rrustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
5. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-se
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i DSHMS
7. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
8. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
9. Remzi Mehmeti, Drejtor i DMSH
10. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR
11. Imer Rustemi, Drejtor i DI
12. Burim Rustemi, Shef i kabinetit
13. Vlora Krasniqi, shefe e zyrës ligjore
14. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Përfaqësues , “YAHR”
17. Përfaqësues të OJQ “POLIS”
18. Përfaqësuesit e mediave
19. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
20. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
21. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë të gjithë anëtarët nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Xhevat Olluri, unë kam një vërejtje te pika e pestë e rendit të ditës jo për ta hjekur këtë pikë por ka qenë mirë që deri të vijmë te shqyrtimi i sajë ta kemi SIVI-në anëtarit të propozuar në KKSB në mënyrë që të dijmë se kend po e zgjedhim në KKSB.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, propozoj që deri të vijmë te shqyrtimi i kësaj pike, zyra ligjore të siguron SIVI-në për anëtarin e propozuar në KKSB.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për miratoi këtë rend dite.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të të Kuvendit
2. Raporti i shpenzimit të buxhetit, realizimi i të hyrave dhe realizimi i investimeve kapitale për nëntë mujorin e vitit 2016

3. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2017
4. Propozim Vendim për shpalljen e Zonave me Interes Publik, zona kadastrale Lipjan dhe zona kadastrale Babush i Muhaxherëve
5. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së
6. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
7. Informatë mbi planifikimin e të mbjellurave vjeshtore

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush ndonjë pyetje.

Hajrije Salihu, unë po e ngriti qështjen e një gruaje që e admiroj dhe ajo është gruaja e dr. Sami Bedrollit e cila disa herë ka kërkuar takim me Kryetarin dhe nuk ka mund të takohet e gjithashtu ka parashtrur kërkesë me shkrim për zgjidhjen e problemit të strehimit dhe më është lutë që qështjen e sajë ta paraqesë në Kuvend.

Të gjithë e dijmë se bashkëshorti i sajë është mjek por është sëmure në ish armatën Jugosllave dhe tani është në gjendje të vështirë dhe kërkojmë strehim.

Si qështje e dytë është qështja e shkollës “Adem Gllavica” ku xhamat janë thyer dhe është mirë që këta xhama së shpejti të rregullohen.

Ukë Kryeziu, unë kam pyetje për Drejtorin e DRKS-së se a ka mundësi që të zgjatet orari i punës së Bibliotekës së Qytetit dhe atë deri në ora 19,⁰⁰.

Florent Hoxha, unë po i ngrisë dy shqetësime: e para është shqetësimi i qytetarëve të fshatit Shalë dhe Kleçkë ku rruga e cila është shtrur nga Ministrija e transportit Shalë-Kleçkë kanalet e saj janë mbyll dhe kërkoj që mundësisht këto kanale të hapen në mënyrë që kjo rrugë mos të shkatërrohet.

Shqetësim tjetër është i qytetarëve të Lipjanit për rrugën 4 korsi në Lipjan dhe pyesin se deri ku kanë shkuar punët dhe a është duke punuar sipas dinamikës së përcaktuar.

Ramiz Qeriqi, kam pyetje për Kryetarin e Komunës dhe më vjen keq që nuk është këtu dhe unë në disa mbledhje më parë e kam ngritë qështjen e ujit që del te një ndërtesë dhe Kryetari më ka thënë se e kemi rregulluar këtë ujë por unë sot po e përsërisë se nuk është rregulluar fare.

Për shkollën në Grackë kam bërë pyetje disa herë dhe nuk kam marrë përgjegjje sikur kjo shkollë mos të ishte në Republikën e Kosovës.

Te objekti i ri në gjimnaz është një kompani private e sigurisë dhe më intereson se a ka pasur tender për këtë dhe kush i paguan ata punëtorë na si prind apo Komuna.

Unë kam parë vetë aty se nxënësit kur kanë shkuar në eskurizion në Shqipëri para se të nisen kanë dalë me i thy paratë dhe kur janë kthyer me hy brend roja nuk i ka leju.

Për Drejtorin e shëndetësisë sigurisht se e dinë se në emergjencë çfarë automjete ka dhe shefi i emergjencës ka bërë një kërkesë por nuk dijë se a e ka marr Kryetari.

Për Lipjan është mirë që po punohet por drunjët që janë mbjellë janë mbjell shpesh a dhe unë e kam parë një grua me karroc që nuk mund të hynte në trotuar për shkak se drunjët janë të mbjellur shpesh.

Pastaj tha se më vjen mirë që sot në rend dite është informata për bujqësi dhe pyes Drejtorin pse ushtarit Osman Vuniqi nuk ju ka ndarë sera.

Për Krojmir ka shumë probleme dhe kanalizimi shpesh herë del mbi sipërfaqen e tokës, ndërsa në lagjen Meta, Olluri dhe Rizani rryma është shumë e dobët.

Te gurthyesi që i është dhënë Eurokosit aty është formu një grop e madhe dhe ka pasur për obligim me e mbyll por nuk e ka mbyll e gjithashtu kur bëhet minimi pusët e ujit trullohen.

Enver Kozhani, tha se në qytet dhe fshatra është duke u rritur numri i qenëve endacak ku shumë prej tyre janë edhe të smurë dhe ekziston rreziku për ndonjë epidemi, andaj pyes se a është ndërmarrë diçka lidhur me këtë qështje.

Feriz Hasani, pyeti se sa kafsh kanë ngordhë në territorin e Komunës së Lipjanit nga smundja gungore dhe si është bërë varrosja e tyre.

Merita Zeqiri-Hajrizi, ngriti shqetësimin e punëtorëve të punësuar në sektorin privat ku nuk zbatohet Ligji dhe shkelen të drejtat elementare të këtyre punëtorëve dhe lidhur me këtë pyes inspektorin se a ka bërë ndonjë kontrollë në kompanitë private.

Hajrije Salihu, me që erdh Kryetari dashta ta pyes për kërkesën e bashkëshortës së Sami Bedrollit dhe qka ka ndërmarr lidhur me kërkesën e sajë.

Xhevat Olluri, po e paraqes shqetësimin tim për shkollat e mesme ku frekuentimi i automjeteve është e madhe dhe vozitet shpejt e gjithashtu edhe frekuentimin e nxënësve është tërë ditën dhe pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike se a ka mundësi që para këtyre shkollave të vëhen pengesa në rrugë në mënyrë që vozitësit të detyrohet të zvogëlojnë shpejtësinë.

Me që pyetje tjera nuk pati Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit duke kërkuar falje për vonesën. Pastaj tha se unë do të përgjigjem ato pyetjet të cilat arrita të dëgjoj dhe së pari i përgjigjem Hajrijes se bashkëshortën e Sami Bedrollit e kam takuar sot dhe të gjithë e dijmë gjendjen e Samiut dhe po them se Komuna nuk ka mundësi që të gjithë atyre që kanë nevojë me u zgjidh problemin e strehimit. Pastaj tha se Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër ka filluar rexhistrimin e të gjitha banesave që janë në pronësi të Komunës dhe pas përfundimit të punës do të fillojnë procedurat për ndarjen e këtyre banesave.

Për qenët endacak e dijmë këtë problem të gjithë dhe nuk e di se ndonjë Komunë e ka zgjidh këtë problem dhe jemi duke punuar në këtë drejtim me komunat fqinje por nuk është problem i lehtë me e zgjidhë këtë.

Për kërkesën e profesorit Xhevat është mirë me i qitë pengesat dhe do të bisedoj me Drejtorin e Shërbimeve Publike.

Për xhamat në shkollën “Adem Gllavica” ky problem do të zgjidhet shpejt dhe është e kontraktuar kompania, vetëm se duhet të paraqitet kërkesa nga drejtoria.

Sa i përket pyetjes së Luanit për rrjedhjen e ujit te një ndërtesë unë jam i njoftuar se është evitu kjo prishje por ndoshta nuk jam informuar drejt.

Merita Zeqiri-Hajrizi, unë nuk mora përgjigje për pyetjen nga Kryetari?

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, kërkoj falje Meritë se e harrova dhe është e vërtetë se në kompanitë private është orari i stërgjatur i punës mirëpo po ju themë të drejtën se kjo nuk është kompetencë e jona.

Pastaj u kalua sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të Kuvendit?

Daut Azemi, unë kam një vërejtje te ekstrakt në faqen 2 ku është thënë se Daut Azemi dha vërejtje në rendin e ditës dhe unë nuk kam dhënë vërejtje në rendin e ditës andaj kërkoj që të përmirësohet.

Meqë vërejtje tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 33-të të Kuvendit me vërejtjen e Daut Azemit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali e mbledhjes së 33-të të Kuvendit me vërejtjene Daut Azemit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i shpenzimit të buxhetit, realizimi i të hyrave dhe realizimi i investimeve kapitale për nëntë mujorin e vitit 2016

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Drejtorit për Buxhet dhe Financa, z. Shkelzen Hajdini, i cili në vazhdim përmes kinoprojektorit i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i cili sajón pjesën përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, tha se Buxheti për periudhën raportuese është shpenzuar me 82.60% dhe opinionin ynë është se ky buxhet është shpenzuar kënaqshëm dhe gjenë përkrahje nga grupi parlamentar i LDK-së. Pastaj përmendi shpenzimet nga granti qeveritar të cilat janë realizuar me 87.64% të hyrat vetanake nga grupi 21 me 48.37% të hyrat vetanake të bartura nga grupi 22 70.29% dhe donacionet 99.75%. Pastaj specifikoj shpenzimet sipas kategorive ekonomike si vijon: Paga dhe medijtje 101.10% mallra dhe shërbime 55.59%, subvencione dhe transfere 53.72%, investime kapitale 55.55% dhe shpenzimet komunale 66.10%. Në vazhdim tha se shqetësimi ynë është te granti qeveritar që të shpenzohen mjetet se më shumë meqë nëse nuk realizohen këto mjete atëherë shkojnë në suficit. Në vazhdim paraqiti shpenzimet sipas programeve dhe kategorive ekonomike të përgatitura me shkrim të cilat janë pjesë përbërse e procesverbalit.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë raport dhe kemi vërejtjet tona si vijon:

Në disa dikastere shpenzimi është i ulët dhe unë do t'i përmendi radhazi. Diferenca e realizimit të shpenzimeve krahasuar me vitin e kaluar është vetëm 2%. Te Drejtorati i Shërbimeve Publike shpenzimet janë vetëm 55%, Te Drejtorati për BPZHR shpenzimi është vetëm 29%, te Drejtorati për KR dhe Sport shpenzimi është vetëm 69%, te shërbimet sociale shpenzimi është vetëm 62%. Në vazhdim tha se shqetësimi jonë është se të gjithë e dijmë se kemi një planifikim të shpenzimit të buxhetit dhe çdo herë shpenzimin e buxhetit po e lëmë në fund të vitit dhe dihet se në fund të vitit shpenzimet mund të bëhen sa për të realizuar buxhetin vend e pa vend vetëm për ta shpenzu dhe këtu mund të ketë edhe shkelje ligjore.

Raporti i shpenzimeve krahasuar me vitet e kaluara është e vërtetë se është më ndryshe dhe shpenzimet janë paraqitë në mënyrë më detale. Te shërbimet me kontrata unë nuk po e kuptoj dhe sipas mendimit tim këtu mshifet diqka. Te të hyrat vetanake e pamë se përqindja është tejkalu por te objektet publike përqindja ka rënë. Te tatimi në pronë e pamë se edhe këtu përqindja e planifikuar është tejkaluar. Në fund kërkoj që të paraqitet se sa mjete për tatim në pronë janë realizu në bazë të Ligjit për faljen e borxheve.

Blerim Gashi, unë falenderoj Drejtorit për paraqitjen e këtij raporti të detajuar i cili me të vërtetë është më ndryshe nga raportet tjera dhe shpenzimet janë paraqit në mënyrë më detale. Sipas këtij raporti shihet se mbledhja e të hyrave ka një avansim. Sipas mendimit tim te investimet kapitale nuk është në rregull që gjysma e buxhetit të planifikuar të realizohet në tre mujorin e fundit.

Petrit Kelmendi, në KPF e kemi shqyrtu këtë raport dhe dashta të pyes se a ka kaluar rishiqimi i buxhetit dhe nëse po pyes se në cilën fazë të realizimit është rishiqimi i buxhetit. Në vazhdim pyeti se a është respektu plani i prokurimit për investime kapitale dhe si është implementimi i projekteve në teren. Në fund pyeti se si ka ndiku Ligji mbi faljen e borxheve te të hyrat vetanake.

Ali Stublla, pyeti Drejtorin lidhur me kodin e shpenzimeve për zyre se nuk e kam të kuart, gjithashtu pyeti se projektet të cilat nuk janë realizu a ka mundësi të realizohen për këta tre muaj.

Lulzim Rustemi, pyeti për shërbimet këshëllimore ku janë këto shpenzime unë e kam të pa kuartë. Te të hyrat vetanake është mirë që këto mjete të shpenzohen brenda këtij viti e jo të bartën shuma të mëdha në vitin e ardhshëm.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja i dha fjalën Drejtorit për Buxhet dhe Financa Shkelzen Hajdini i cili fillimisht u përgjegj për shqetësimet e Agronit lidhur me realizimin e projekteve që financohen nga granti qeveritar duke shtuar se këto mjete deri në fund të vitit do të realizohen. Te Florenti që përmendi realizimin e ulët te disa dikastereve e sidomos te Drejtorati Shërbimeve Publike në realizimin e projektev ku gjatë periudhës raportuese janë realizu vetëm 55% dhe ju them se kjo ndodh çdo herë për shkak të procedurave të prokurimit por ju garantoj se deri në fund të vitit do të realizohen planifikimet nga granti qeveritar. Te bujqësia kemi 100 mijë euro sobvencione dhe shohim se nuk janë shpenzu tërësisht por gjatë kësaj periudhe që kanë mbetë do të realizohet. Te Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport realizimi i shpenzimeve është 26.36% dhe në këtë Drejtorat janë të planifikuara disa investime kapitale e deri në fund të vitit mjetet e planifikuara do të shpenzohen. Në mallëra dhe shërbime përqindja e shpenzimit është e ulët por dihet se për furnizimin me dru dhe thëngjill në tremujorin e fundit rriten shpenzimet. Te të hyrat vetanake na nuk jemi të kënaqur dhe sikur të ishte implementu Ligji mbi faljen e borxheve sigurisht realizimi do të ishte më i mirë.

Te pyetja e Petritit se a ka kaluar rishiqimi i buxhetit ju njoftoj se ka kaluar rishiqimi i buxhetit dhe mjetet janë aloku.

Te pyetja e Aliut për shpenzimet për zyrë dhe ushqim ju njoftoj se këtë e bëjmë për të gjitha organizatat buxhetore.

Te pyetja e Lulit për shërbimet këshëllimore nga ky kod na finansojmë trajnimet e stafit dhe konsideroj se këtu janë pak mjete.

Te të hyrat nga qiraja kemi ramje por këtu ka hapsirë të veprojnë dhe Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim është duke punuar për këtë qështje.

Meqë çështje tjera rreth kësaj pike nuk pati e me kërkesë të anëtarëve të Kuvendit Kryesuesja dha pauzë në ora 12,⁰⁵ deri në ora 13,²⁵.

Pas pauzës në ora 13,30 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së tretë.

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2017

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, tha se këtë Plan e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe kemi pasur një propozim nga profesori Xhevat që në janar të ipet një informatë nga prokurimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Xhevat Olluri, me Ligj është parapa që të bëhet Plani i prokurimit andaj edhe paraqitja e informatës së prokurimit duhet të parashihet për janar.

Enver Kozhani, propozoj që për shtator kur është planifiku shqyrtimi i informatës për fillimin e vitit shkollor t'i shtohet kësaj informate edhe pranimi i kuadrit arsimor.

Blerim Gashi, ky Plan është i mirë por nuk do të thotë se nuk mund të ndryshohet. Te arsimi e kemi pasur të paraparë informatën për shkurt për përfundimin e gjysëm vjetorit të parë dhe propozoj që kjo informatë të paraqitet në janar.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni tha se unë po i lexoj propozimet për plotësim të Planit si vijon:

Në janar ishte propozimi i Xhevatit për informatën e prokurimit, gjithashtu për janar ishte propozimi i Blerimit për informatën e arsimit për përfundimin e gjysëm vjetorit të parë, gjithashtu informata e paraparë e prokurimit për qershor të bartët në dhjetor dhe informata për fillimin e vitit të ri shkollor e paraparë në shtator t'i shtohet edhe pranimi i kuadrit.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozim Vendimin për miratimin e planit orjentues të punës së Kuvendit me ndryshimet e cekura më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2017

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon t'i mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

RENDI I DITËS		AL
JANAR 2017	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2017	
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2016	
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	
	Harmonizimi i Rregullores për Transparencë	
	Plani për Trashigimin Kulturor	
	Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor	
	Informatë mbi Planin e Prokurimit	
SHKURT 2017	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	
	Rregullorja për taksa mjedisore	
	Informatë nga Egzekutivi i Komunës për implementimin e Planit të MSA-së	
MARS 2017	Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve	Vizita në teren në lidhje me implementimin të investimeve
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2016	
PRILL 2017	Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2016	Formimi i grupit punës për veprimet për procesin e legalizimit duke i përfshirë edhe subjektet e interesit
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
Maj 2017	Informatë mbi Qarkoren e pare buxhetorete MF-se	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Informatë mbi punën e komiteteve funksionale	
QERSHOR 2017	Miratimi i Korrnizës Afatmesme Buxhetore 2018-2020	Diskutim Publik i Korrnizës KAB
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2017	
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
KORRIK 2017	Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2017	
	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2016	
	Informatë mbi Raportin e Performancës	8
	Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor	

	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Fillimi i përgatitjes për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018	
GUSHT 2017	Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se	
SHTATOR 2017	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2018	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018	
	Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor dhe pranimi i kuadrit arsimor	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë	
TETOR 2017	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2017	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
NËNTOR 2017	Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore	
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Informatë e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi të mbjellurat	
DHJETOR 2017	Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2018	
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	
	Informatë mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2018	
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së	
	Informatë nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport	
	Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit	

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-s dhe publikimin në gjuhët zyrtare në Webfaqen e Komunës.

Neni 7

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Vendim për shpalljen e Zonave me Interes Publik, zona kadastrale Lipjan dhe zona kadastrale Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoj të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi i cili është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, na si grup parlamentar i PDK-se e kemi analizu këtë propozim Vendim dhe ky Vendim është i arsyeshëm dhe na si grup parlamentar e përkrahim.

Daut Azemi, edhe na e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe është interes i qytetarëve, andaj si grup parlamentar e përkrahim.

Ramiz Qeriqi, edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim por e kam një pyetje për Drejtorin se a ka ndonjë obligim Komuna ndaj AKP-së aty ku ka ndërtesa.

Hajrije Salihu, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim por dashta të pyes për Shtëpinë e Kulturës në Babush në mandatin e kaluar është folë se kjo Shtëpi e Kulturës ka një rëndësi të veçantë historike dhe është përmend emëri i Gjon Sereqit, dhe aty kanë mbajtur disa mbledhje.

Ilir Tasholli, te pyetja e Ramizit se a kemi obligim ndaj AKP-së unë ju njoftoj se edhe në pushtetin e kaluar edhe ekzekutivi edhe legjislativi kanë bërë kërkesa në AKP për marrjen e këtyre objekteve por gjerë tani nuk janë aprovuar kërkesat tona mirëpo pas aprovimit të këtij Vendimi na do t'i vazhdojmë bisedat me AKP-ne dhe do të shohim si do të vendosim.

Për Shtëpinë e Kulturës në Babush që pyeti Hajrija se kjo Shtëpi e Kulturës është folë se ka një rëndësi historike dhe hynë në kuadër të trashëgimisë kulturore kët unë nuk di për sigurisht më mirë e din Drejtori i DKRS-së.

Basri Hashani, Drejtor i DKRS-së tha se sa i përket Shtëpisë së Kulturës në Babush të Muhaxherëve na nuk kemi informata se kjo është në kuadër të trashëgimisë kulturore dhe ka një vlerë historike.

Daut Azemi, ate që e tha profesoresha Hajrije ka pasur diqka se aty janë mbajtur disa takime por unë nuk besoj se ky objekt është i mbrojtur dhe është i shkatërruar që nuk ka mundësi që të renovohet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me vërejtjet e Drejtorit që në nenin 1.1 të njësija kadastrale P-71409044-01189-1 në vend të njështit është pesë dhe të bëhet përmirësimi dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E ZONAVE ME INTERES PUBLIK-PARCELAT KADASTRALE
NR.1767-1,NR.1189-5 ZONA KADASTRALE LIPJAN DHE NR.353-1,Nr.353-4 ZONA
KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

1. Me qëllim të realizimit të planeve urbane sipas Vendimeve të miratuara në Kuvendin Komunal të Lipjanit 1Nr.350-521 të datës 01.06.2009 dhe 15Nr.12514 të datës 23.08.2013, SHPALLEN Zona të Interesit Publik parcelat kadastrale si vijon:

1.1. Njësia kadastrale P-71409044-01189-5 në vendin e quajtu “pashnike” me kulturë livadh i kl.1-parë me sipërfaqe prej 5985m² Zona kadastrale Lipjan, P.Sh. Automoto e Kosovës.

1.2 Njësia kadastrale P-71409059-00353-1 në vendin e quajtur “Zaline” shfrytëzimi aktual i pronës kullosë, oborr,shtëpi-ndërtesë me gjithsej sipërfaqe prej 13730m² Zona kadastrale Babush i Muhaxherëve, P.Sh. Minjera e Lignitit.

1.3 Njësia kadastrale P-71409059-00353-4 në vendin e quajtur “Zaline” shfrytëzimi aktual i pronës kullosë,shtëpi-ndërtesë,oborr me gjithsej sipërfaqe prej 4769m² Zona kadastrale Babush i Muhaxherëve,P.Sh. Minjera e Lignitit.

1.4 Objekti i kooperativës bujqësore “Kosova” me të cilën menagjon Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) ekziston në parcelën kadastrale P-71409044-01767-1 në vendin e quajtur “Varosh” shfrytëzimi aktual i pronës jo pjellore,shtëpi-ndërtesë me gjithsej sipërfaqe prej 3295m² Zona kadastrale Lipjan P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

1. Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal miratuar me Vendimin të Kuvendit Komunal Lipjan 1Nr.350-521 të datës 01.06.2009 për aprovimin e planit rregullues urban të qendrës së qytetit dhe të Vendimit 15Nr.12514 të datës 23.08.2013 për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban të Lipjanit, parcelat kadastrale siq përcaktohen si në neni 1 të këtij vendimi dhe të cilat menagjohen nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) dhe bazuar në Informacionin Urban të prezentuar nga Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Nr.8-350-40501 të datës 08.08.2016 janë pjesë e zonave të planifikuara.

2.Qëllimi i kthimit të tyre sipas dispozitave ligjore në pronësi të komunës së Lipjanit, është si vijon:

2.1 Objekti i kooperativës bujqësore “Kosova” me të cilën menagjon Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) ekziston në parcelën kadastrale P-71409044-01767-1 Zona kadastrale Lipjan P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan ku sipas Planit rregullues Urban “Qendra” është koncentruar në pjesën që përfshijnë Blloqet Urbane, Blloku “F3”,Destinimi: Ndërtesa ekzistuese me destinim administratë dhe funksione përcjellëse.

2.2 Parcela kadastrale P-71409044-01189-5 në Lipjan është koncentruar në Zonën Urbanistike përfundimtare “ZUP-1” ku pjesa e parcelës në fjalë është destinuar për aktivitete të tregëtisë, mundësia e dislokimit të tregut.

2.3 Parcela kadastrale P-71409059-00353-1 në pronësi të Minjerës së Lignit (në menagjim të AKP-së) në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve është ndërtuar dhe funksionon shkolla fillore e Mesme të Ulët “ Ernest Koliqi”.

2.4 Parcela kadastrale P-71409059-00353-4 në pronësi të Minjerës së Lignit (në menagjim të AKP-së) në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve është objekti i vjetër i kulturës (dhe sipas gjendjes faktike ky objekt tani nuk funksionon (sipas gjendjes faktike një pjesë e objektit është rrënuar dëshmohet me Raportin e Komisionit Komunal për vlerësim të rrezikshmërisë i datës 20.07.2016), andaj sipas Planit Zhvillimor Komunal, destinimi dhe të dhënat tjera rreth definimit të kushteve të përgjithshme të ndërtimit do të definohen me rastin e hartimit të dokumenteve tjera planore me theks Harta Zonale e Komunës.

Neni 3

Pas marrjes së Vendimit nga ana e AKP-së për kthimin e parcelave kadastrale në pronë Komonale të KK.Lipjan të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër do të bëjë regjistrimin e parcelave kadastrale në pronë komunale.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Neni 6

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBS-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Haqif Rrustemit, përfaqësues i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpetim i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit. Në vazhdim tha se deri më tani nuk kemi kërku biografi për asnjë anëtar por sot u kërkua nga profesori Xhevat.

Nazmi Krasniqi,në këtë civi nuk është bashkangjite letërnjoftimi i kandidatit të propozuar për anëtarë të KKSBS dhe unë jam kundër këtij Vendimi.

Xhevat Olluri, unë e kërkoja civilin për kandidatin e propozuar por Haqifi e tha se nuk kemi kërku civilin për kandidatët tjerë dhe unë konsideroj se atëherë Kuvendi e ka marrë këtë Vendim ka gabuar që nuk ka kërkuar civilin.

Haqif Rustemi, Kuvendi është bazu në udhëzimet administrative të cilat kanë ardhur nga Ministritë për formimin e KKS-së dhe në ato udhëzime nuk parashihet që të kërkohej civilin e gjithashtu edhe Ligji e rregullon këtë materie dhe na ju kemi përmbajtur Ligjit.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 2 kundër miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKS-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKS-së

Me këtë Vendim zëvendësohet anëtarja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi Znj. Dragana Trajković nga komuniteti serb, në numrin rendor 7 të pikës I të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014 dhe në vend të saj caktohet **z. Zoran Radić** nga komuniteti serb në Lipjan në pajtim me shkresën –kërkesën e komunitetit serb nr. 1-031-55797 të datës 07.10.2016.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKS-së është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunalë për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKS në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Neni 4

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Drejtorit të DKRS, Basri Hashani, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ramiz Qeriqi, ka qenë mirë që këtij Vendimi t'i pashkangjiten edhe emërat e personave që kanë vdekë.

Hajrije Salihu, në KPF e kemi shqyrtu këtë Vendim dhe kemi kërku që Vendimit të i bashkangjitur me emër dhe mbiemër të personave të vdekur.

Basri Hashani, për të gjitha rastet listat janë në zyrën ligjore dhe kush të doj mund të shkoj të verifikoj këto lista.

Nazmi Krasniqi,unë e përkrahi Ramizin plotësisht se nëse listat janë pse nuk i'a bashkangjit Vendimit.

Vlora Buja, edhe na e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për miratoi këtë:

VENDIM PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **11.000,00€**, (njëmbëdhjetë mijë e euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 100 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur prej datës 22.06.2016 deri më 13.10.2016 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 100 = 11.000,00€$,

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 4

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

Shtesë: Vendimi.

VII

Informatë mbi planifikimin e te mbjellurave vjeshtore

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, para se t'i jep fjalën Drejtorit tha se në informatë është përfshirë edhe korrje-shirjet a në titull të informatës e keni vetëm planifikimin për mbjelljet vjeshtore, pastaj i dha fjalën Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata. Në vazhdim u përgjigj edhe në pyetjet që parashtruan anëtarët e Kuvendit në fillim të mbledhjes si vijon:

Në pyetjen e Ramiz Qeriqit pse Osman Vuniqit nuk i është ndarë sera tha se Osman Vuniqi ka konkuru dhe është në listë i 147 dhe është në pritje për ndarjen e serës nga "TIKA" pastaj u përgjigj në pyetjen e Ferizit në lidhje me numrin e kafshëve të ngordhura duke shtuar se në territorin e Komunës së Lipjanit nga smundja gungore kanë ngordh 35 kafshë dhe 31 prej tyre janë varros në Kërçevë me shpenzime të Komunës dhe 4 të tjera me shpenzime të agjensisë së veterinarisë dhe ushqimit të cilat janë varros në Brus.

Linda Shahini, kam pyetje për Drejtorin se të gjithë e dijnë se këtë vit ka pasur dëmtime të fermerëve dhe a ka pasur mundësi Komuna me i rimbursu këta fermer.

Enver Kozhani, pyes Drejtorin se si është konstatu gjendja e kombajnave se ka qenë e mirë kur te ne kanë qenë disa kombajna tu fshi dhe gjendja e tyre ka qenë shumë e keqe përveq një kombajne që ka qenë e jashtme. Pastaj pyeti se a është respektu çmimi i korrje-shirjeve të cilën e ka caktuar Ministria. Në vazhdim tha se në të ardhmen është mirë që të ketë kontrollë të auto kombajanave se në qfarë gjendje teknike janë dhe në fund propozoj që në kuadër të mundësive të organizohet trajnim me bujqit në mënyrë që bujqit të përcaktohen më shumë në mbjelljen e bimëve industriale të cilat janë më profitabile.

Arben Bahtiri, tha se gjatë këtij viti ka pasur vjedhjeve të gjedheve e më konkretisht në Magure Muhamet Kurtshit ju kanë vjedhur 4 gjedhe dhe është në gjendje të rëndë materiale prandaj është mirë që Komuna mundësisht t'ia kompenzoj këto apo edhe qoftë t'i ndihmoj me ndarjen e një sere.

Lulzim Rrustemi, pyeti se a ka kompenzime për dëmet që ju kanë shkaktu fermerve nga fatëkeqësitë natyrore.

Feti Krasniqi, dhe se ne i kemi vlerësu dëmet nga fatëkeqësit natyrore dhe i kemi dërgu në Ministri dhe Ministria për vërsimet që kanë ndodh ka ndarë 26 mijë euro dhe brenda javës së ardhshme bujqit do t'i realizojnë këto mjete të dëmeve. Sa i përket vlerësimit të gjendjes së mekanizmit na i kemi shenimet dhe emërat e të gjithë atyre që posedojnë kombajna dhe është interes i atyre që posedojnë kombajnë që t'i mirëmbajnë në të kundërtën ata humbin. Çmimi i kombajnave është zbatu 90%.

Hajrije Salihu, pyeti se sa femra janë duke u marr me bujqësi dhe qka kanë përfitu.

Feti Krasniqi, po kemi femëra që merren me bujqësi dhe të gjitha janë të suksesshme në këtë lëmi.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,³⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni